

Konsulent i pas-shitjes

- 1 pozitë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Të pranojë automjetet për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, riparimet dhe riparimin e defekteve të aksidenteve;
- Të kontrollojë gjendjen e funksionimit të automjetit, të kontrollojë gjendjen e frenave dhe sipas nevojës të testojë automjetin në ngasje i shoqëruar nga klienti;
- Të informojë klientin për gjendjen e automjetit si dhe për pjesët e tij, ta këshillojë për riparimet e nevojshme dhe të llogarisë afersishte shpenzimet e riparimeve;
- Të përcaktojë afatet e riparimit në mirëkuptim me interesat e klientit dhe në bashkëpunim me menaxherin e servisit dhe me depoistin e pjesëve të këmbimit.
- Të plotësojë librin e shërbimit të makinave.
- Të verifikojë perfundimin e punëve të parapara sipas kërkesave të klientit para dorëzimit të veturës të klienti.

Specifikat e punës:

- E preferueshme të ketë Diplomë të Universitetit;
- Duhet të jetë në gjendje të punojë nën presion;
- Njohuri të gjuhës angleze; Preferohet edhe gjuha serbo-kroate.
- Aftësi të mira organizative dhe menaxhuese.